

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.11.2022*

03.11.2022  
Ora, 12:05

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për shqyrtimin e kërkesës së Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **Shoqëria civile:**      **Z. Kristaq Kume**
- **OJQ:**      **KRIK**


**Z. I. Celibashi:** Fillojmë seancën publike, e cila ka në rend dite këto çështje:

Projektvendimin “Për shqyrtimin e kërkesës së Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Pika e dytë, projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan”;

Pika e tretë, projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll”.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.11.2022*

Pika e katërt, projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier”.

Ndërkohë janë dhe dy çështje të mbetura nga seanca e shkuar:

Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”, si dhe

Projektudhëzim “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre”.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Komitetit Përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve për regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Prezent është zoti Kume të cilit i japim fjalën si përfaqësues të këtij projekti, kësaj nisme për të prezantuar këtë dhe për të vazhduar më tej.

**Z. Kristaq Kume:** Faleminderit zoti Celibashi! Është hera e parë, dua ta theksoj, shprehjen e mirënjohjes dhe konsideratës për çfarë kemi bërë së bashku. Mbështetjen që ju na keni dhënë që në krye të herës për këtë nismë. Vlerësimin që ju i keni bërë kësaj nisme si një ndër mundësitë e mira që legjislacioni ynë duhet t’ju ofrojë qytetarëve të Shqipërisë për të ushtruar të drejtën e tyre për zgjedhjen e përfaqësuesve dhe në këtë rast, përfaqësuesve vendorë për këshillin bashkiak. Grupi nismëtar i përbërë nga drejtues të nëntë organizatave të shoqërisë civile të gjithë së bashku, tashmë kanë formësuar edhe atë që është emërtuar “Aleanca Qytetare për Demokraci”. Të mbështetur dhe në kooperim pas një viti e gjysëm, të nisur më parë nismën për të trajtuar probleme që kanë si objektiv vlerësimin e asaj ç’ka legjislacioni ofronte dhe mundësonte rregullimin e mëtejshëm të këtij legjislacioni,


*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.11.2022*

gjithmonë në funksion të mirëfunksionimit të demokracisë përfaqësuese në nivel vendor. Në realizim të këtij objektivi, partnerët pasi zhvilluan një proces intensiv kontakti me qytetarët, me grupe të ndryshme të interesit, pasi përpunuan të gjithë opinionet e mendimet e shprehura në këto takime, formuluan draftin për ndryshimet që mund të propozohen për t'u bërë në legjislacion. Këto ju nënshtruan pastaj një procesi të gjatë konsultimi. Rezultat i të cilit ishte drafti ku është menduar se mund të shërbejë si zgjidhje e cila do të bëjë që përfaqësimi në këshillat bashkiakë të jetë më cilësor se sa ky që është sot. Për ta çuar deri në fund këtë gjë ne duam që të përdorim të drejtën kushtetuese, e cila parashikon që 20% qytetarë në qoftë se kanë një vullnet të përbashkët mund ta nxisin dhe ta realizojnë nismën ligjvënëse, duke çuar në fund të saj, në Kuvendin e Shqipërisë një projekt nismë. Sipas ligjit për nismat qytetare ligjvënëse, ne ju drejtuam institucionit tuaj, me kërkesën që të na pajisni me formularin-tip për marrjen e nënshkrimeve. Kujtoj në atë mbledhje të parë ku ne paraqitëm idenë, mendimin tonë me atë ç'ka synonim të realizonim, konsideratat që ju shprehët, ju dhe gjithë bashkëpunëtorët tuaj. Të cilat ishin në fakt, jo vetëm për mua, por dhe për të gjithë kolegët e mi, mbështetje frymëzuese për atë që na priste të bënim. Natyrisht e nisëm punën me entuziazëm dhe puna na tregoi se entuziazmi nuk mjaftonte, duhej diçka më shumë se sa kaq. Duhet të mendonim mënyrën se si duhet të qaseshim me qytetarët, gjë që na bëri t'ju drejtoheshim përsëri me kërkesën për të na dhënë më shumë kohë në dispozicion, nga ajo që ju kishim kërkuar më parë për ta realizuar këtë nismë. Pra, për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse. Mirëkuptimi ishte i plotë, ju na e dhatë këtë mundësi. Ne sot jemi këtu me punën e përfunduar me më shumë se sa e parashikon legjislacioni. Pra, jo me njëzet mijë qytetarë, por me më shumë. Punë e cila na tregoi se si dhe në çfarë mënyre duhet punuar me qytetarët, duke u zhveshur nga ajo që "qytetari është indiferent", "qytetari stepet". Jo, qytetarit duhet të dish se si t'i afrosh, duhet të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.03.11.2022*

dish se si të punosh me të. Gjë që, i nderuar zoti Celibashi, është një përvojë që unë do të doja me shumë kënaqësi ta shkëmbeja me ju edhe duke pasur si objektiv, duke pasur parasysh atë se çfarë përveç të tjerave, institucioni juaj zhvillon tek edukimi qytetar për procesin zgjedhor. Si duhet t'i ofrohemi më mirë qytetarëve për t'i bërë ata sa më aktivë në një proces zgjedhor, duke ju referuar dhe procesit të ardhshëm që shumë shpejt është për t'u realizuar. Tashmë ndodhemi në kushtet ku ne sipas ligjit duhet të kalojmë dhe këtë fazë dhe t'i drejtohemi pastaj Kuvendit të Shqipërisë. Ajo që mbetet në fund të fjalës time ka të bëjë me faktin se e gjitha ç'ka ne kemi realizuar deri me sot së bashku, na shëben ne nismëtarëve të kësaj nisme ligjvënëse qytetare edhe si përvojë për t'u mirorganizuar, për të mirërealizuar marrëdhënien me institucionin tjetër, me Kuvendin e Shqipërisë.


**Z. I. Celibashi:** Dakord! Ne e pranojmë këtë kërkesë dhe bazuar në nenet 19, pika 2 dhe 71 të "Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 14, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 54/2019 "Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë" si dhe udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit", vendos:

- Regjistrimin e nismës ligjvënëse të zgjedhësve "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar".
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij. Suksese!

**Z. Kristaq Kume:** Faleminderit!

**Vendimi nr. 203**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

**03.11.2022  
Ora, 12:14**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan, me kandidatën nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonja Areta Mehmet Kumria”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **OJQ:**    **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikat e tjera të rendit të ditës, kemi projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan”.

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Elbasan, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zoti Klevis Bardhyl Çullhai, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë. Referuar nenit 164 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, të cilës i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 48, zonja Areta Mehmet Kumria, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 46. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se kandidatja nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

Qendror i Zgjedhjeve ka marrë informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Rezulton se kandidati nuk ka ndryshime të përbërësve të gjendjes civile. Zyra e Gjendjes Gjyqësore ka dorëzuar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku konstatohet se kandidatja nuk është dënuar me vendim të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e zonjës Areta Mehmet Kumria kandidate për anëtare në Këshillin e Bashkisë Elbasan, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë meqenëse nuk ka asnjë pengesë nga ligji vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Elbasan, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Areta Mehmet Kumria.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 204**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

**03.11.2022  
Ora, 12:17**

***RENDI I DITËS***

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Gjelbër, zoti Kevin Agron Baçi”.**


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafii KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **OJQ:**    **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll”.

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Devoll, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari zoti Ervis Fatos Begolli, propozuar nga Partia e Gjelbër. Referuar nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë së Gjelbër, për Këshillin e Bashkisë Devoll, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 05, zoti Kevin Agron Baçi, i cili ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 45 Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se kandidati nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes

**Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

gjyqësore, ku konstatohet se nuk ka ndryshime të përbërësve të gjendjes civile si dhe nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte kandidati për këshilltar në Këshillin e Bashkisë Devoll, nuk përbën kusht për moszgjedhjen e tij në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë meqenëse nuk ka asnjë pengesë nga ligji edhe në këtë rast, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Gjelbër, zotin Kevin Agron Baçi.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Vendimi nr. 205**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

03.11.2022  
Ora, 12:19

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratia Sociale, zonja Rezarta Gëzim Duro”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Staf i KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**      **S’ka prezent**
- **OJQ:**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Vazhdojmë me pikën e tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier”.

**Z. Y. Merkaj:** Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltaria zonja Oljana Jashar Buza, propozuar nga Partia Demokratia Sociale. Kandidati vijues nga lista shumemërore e kësaj partie që i kalon mandati i këshilltarit është kandidatja me numër rendor 06, zonja Rezarta Gëzim Duro, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 47. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se kandidatja nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë rezulton se kandidati nuk ka ndryshime të përbërësve të gjendjes civile si dhe kandidatit nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte kandidatit Rezarta Gëzim Duro nuk përbën kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


**Z. I. Celibashi:** Mirë edhe në këtë rast vendosim ta miratojmë kërkesën për:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Demokratike Socialë, zonjën Rezarta Gëzim Duro.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda tridhjetë ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Këto ishin të gjitha në lidhje me vakancat.

**Vendimi nr. 206**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

03.11.2022  
Ora, 12:21

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.*


**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:    **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**    **S’ka prezent**
- **OJQ:**    **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021.

**Z. Y. Merkaj:** Në datën 20 tetor 2022, u zhvillua mbledhja e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ku nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve është lënë një afat maksimal deri në datën 27 tetor 2022, për të sjellë propozime partitë politike si dhe organizata të tjera. Deri në këtë moment vetëm KRIK ka sjellë një kërkesë. Partia Demokratike nuk ka sjellë dokumentacion shtesë. Gjithashtu nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është bërë një kërkesë

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*


për shtyrje të mbledhjes, pasi është me raport mjekësor dhe ka shprehur pamundësinë për të qenë prezent. Gjithashtu janë pasqyruar edhe dokumentacioni i raporteve financiare të sjella nga Partia Republikane për dy kandidatët te lista shumemërore Elida Hoti dhe Eralda Bami, të cilat nuk i kishin pasqyruar në mbledhjen e kaluar. Në këto kushte nuk mund të vazhdojmë, përderisa përfaqësuesi i Partisë Demokratike ka kërkuar shtyrje.

**Z. I. Celibashi:** Po KRIK-u çfarë ka kërkuar? Doni ta prezantoni vetë, apo..?

**Znj. V. Ballgjini:** Gjithashtu, dje ka ardhur një kërkesë nga KRIK-u e cila ka bërë gjetjet e saj lidhur me raportin që ne kemi dorëzuar dhe ka disa sugjerime. Një ndër to është edhe mosdeklarimi i 181 zyrave elektorale nga subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet e datës 25 prill. Unë propozoj që nëse dhe ju jeni dakord zoti Komisioner, ta marrim në konsideratë dhe t'ju çojmë një njoftim partive politike lidhur me atë çfarë KRIK-u ka konstatuar, në qoftë se është e mundur.

**Z. I. Celibashi:** Dakord! E shtyjmë, u kërkojmë partive politike informacion shtesë lidhur me gjetjet e organizatës KRIK në lidhje me zyrat që ata kanë evidentuar që kanë ekzistuar, por nuk janë paraqitur në raportet e partive politike, sipas pretendimit të tyre. T'ju japim një afat deri në datën 15 nëntor për të sjellë shpjegimet në lidhje me këto gjetje. Ndërkohë, seancën publike për këtë çështje do ta njoftojmë pasi të marrim informacionet shtesë nga partitë politike. Pra, e caktojmë pas datës 15 nëntor. Meritojnë që të bëhen këto verifikime të këtyre gjetjeve, por duhet të dëgjojmë dhe partitë politike se çfarë pretendimesh kanë lidhur me këto gjetje për këto zyra. Sa ishte numri i zyrave?

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

*Znj. V. Ballgjini:* 181!

*Z. I. Celibashi:* 181 zyra të pa raportuara! Ndërkohë përcilljani edhe gjetjet e raportit të KRIK-ut partive politike.

*Znj. V. Ballgjini:* Dakord!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

03.11.2022  
Ora, 12:24

**RENDI I DITËS**

**Projektudhëzim “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. V. Ballgjini**
- **Parti Politike:**      **S’ka prezent**
- **OJQ:**      **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, që ka të bëjë me miratimin projektudhëzimit “Për përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e monitoruesve në zgjedhje dhe procedurën e emërimit të tyre”. Keni marrë ndonjë sugjerim tjetër përveç atyre që kishit?

**Znj. V. Ballgjini:** Jo!

**Z. I. Celibashi:** Ato ndryshimet i keni reflektuar?

**Znj. V. Ballgjini:** Po!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 03.11.2022*

**Z. I. Celibashi:** Nga partitë nuk keni marrë asnjë propozim tjetër, as nga organizatat? Ato të organizatës KRIK i keni të përfshira? Trajnimin dhe testimin e monitoruesve? Mirë atëherë, e miratojmë edhe këtë projektudhëzim, sipas draftit të ripunuar së bashku me ndryshimet përkatëse. Çështje tjetër?! Nuk kemi!  
Seanca mbyllet ju faleminderit! Faleminderit dhe përfaqësuesve të medias!

**Udhëzimi nr. 3**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

